

SONILA BOÇI: MINORITETET KOMBËTARE NË SHQIPËRI MIDIS IDENTITETIT DHE INTEGRIMIT (1939-1949), Tiranë: Kristalina-KH, 2012, 365 f.

Vite të shkuara, kur drejtoja Institutin e Historisë, e konsiderova përparësi në punën time përzgjedhjen e studentëve të sapodiplomuar, të aftë e të pasionuar, që do t'i bashkoheshin grupit të studiuesve në Institut. Kam pasur atë kohë takime me pedagogë të degës së Historisë të Universitetit të Tiranës, kam qenë e pranishme në provime e në shumë mbrojtje diplomash. Me atë rast njoha dhe studenten Sonila Boçi, e cila në një sallë të katit të dytë të Fakultetit të Historisë e Filologjisë, duke ligjëruar për tezën që përmbyllte studimet e saj universitare, përcillte te dëgjuesi brishtësi dhe qartësi njëherësh. Kjo ishte ndjesia ime e parë, e cila u plotësua më tej pas bisedave të drejtpërdrejta me Sonilën dhe me mësimdhënësit e saj. Përfundimisht, në shtator të vitit 2001, zuri vend në Departamentin e Historisë së Pasluftës të Shtetit Shqiptar, në njërën nga tryezat që deri atëherë e kishte përdorur një studiues i sapodalë në pension.

Më pas, puna e solli që unë të isha bashkëdrejtuese e temës së saj për Master në Universitetin e Athinës "Kapodistria" dhe drejtuese e tezës së doktoratës në Institutin e Historisë. Pas shumë vitesh punë intensive, gjatë të cilëve emri i Sonilës do të dukej në revistat shkencore brenda e jashtë vendit: *Studime Historike, Gjurmime Albanologjike-Histori, Kosova* etj., në konferenca e projekte kombëtare e ndërkombëtare, sot ne kemi në dorë monografinë e saj të parë *Minoritetet kombëtare në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit, 1939-1949*. Një subjekt sa delikat aq edhe i vështirë. Vite me radhë studiuesit shqiptarë i ishin shmangur kësaj teme djegëse, e vështirësuar dyfish edhe për shkak të arkivave të mbyllura. Por ndryshimet demokratike në vend dhe procesi i desekretimit të dokumenteve arkivore bënë të mundur dhe përballjen e autores me këtë temë, që ajo me të drejtë e konsideron "sfidë".

Në rrugëtimin historik të minoriteteve gjatë shekullit XX, Dr.Sonila Boçi trajton në monografinë e saj sjelljen e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve të reja evropiane ndaj minoriteteve kombëtare, si dhe trendin pozitiv të statusit të tyre, një proces i gjatë luftërash, mosmarrëveshjesh, konferencash e traktatesh. Në këtë proces, autorja veçon Presidentin amerikan Udrou Uilson (Woodrow Wilson), i cili pas Luftës së Parë Botërore, shpenzoi gjashtë muaj në Evropë për të shpalosur një sistem të ri parimesh dhe vlerash, për t'i dhënë jetë, paqe dhe shpresë shteteve të rinj demokratikë të sapokrijuar nga rënia e perandorive të mëdha.

Por as harta e re e Evropës, e vijëzuar sipas përkatësisë etnike dhe të drejtës së fitimtarit në Konferencën e Paqes të Versajës, as traktatet për mbrojtjen e

pakicave kombëtare dhe as parimi i vetëvendosjes i nxjerrë nga arkivat dhe i shpalosur sërish në vitet e Luftës Dytë Botërore nuk e zgjidhi krizën e minoriteteve. Miliona njerëz mbetën të ndarë nga shtetet amë dhe u përfshinë si popullsi minoritare në shtetet e rinj evropianë, ku jo rrallë u trajtuan edhe më keq se në perandoritë e mëdha që ishin shembur.

Organizata e Kombeve të Bashkuara duke e kuptuar se sistemi ekzistues i mbrojtjes së minoriteteve kombëtarë në grup kishte dështuar, miratoi një varg marrëveshjesh ndërkombëtare që garantonin të drejtat e të gjithë individëve. Ky proces “universalist” filloi me Deklaratën e të Drejtave të Njeriut, 1948, si një standard i përbashkët “për të gjithë popujt dhe kombet”. Por së bashku me të, filloi dhe Lufta e Ftohtë që ngriu jo vetëm kufijtë fizikë të shteteve por edhe çështjen e minoriteteve.

U desh të kalonin më shumë se pesë dekada që akujt të shkriheshin. Diktaturat u shembën, shtetet rrëshqitën paqësisht drejt demokracisë së ëndërruar. Ajo që nuk pritej ishin fantazmat nacionaliste që filluan të enden në hapësirat e paana të perandorive të dikurshme, duke trazuar shpirtrat e kombeve dhe të minoriteteve për të zhbërë kufijtë. “Përkatësia nacionale”, gatishmëria për t’u flijuar për “atdheun historik” dhe fobia ndaj ish bashkëqytetarëve “jo të një gjaku” morën përmasa të rrezikshme. Krizat u rishfaqën përsëri dhe dilema për të drejtat e minoriteteve etnikë apo për të drejtat e njeriut ndezi debatet në komunitetin ndërkombëtar.

Në Ballkanin shumëkombësh, ku atmosfera ishte e mbarsur me trashëgiminë e “vezëve të Versajës” dhe “hirit të Jaltës” filloi përgjakja. Shqipëria, me një popullsi etnikisht homogjene nuk përjetoi konflikte të dhimbshme, por as nuk qëndroi e paprekur. Kosova, Çamëria, minoritetet etnike e kombëtare u bënë kryefjala e polemikave të shumta në shkrimet e gazetave të përditshme. Në këto kushte, një studim i mirëfillt shkencor për historinë e minoriteteve në Shqipëri u bë imponues.

Sonila Boçi e ka fokusuar punimin e saj në katër drejtime kryesore, ku është bërë kujdes të ruhet kronologjia historike e ngjarjeve dhe proceseve. Fillimisht lexuesi njihet me një përsiatje teorike-historike mbi minoritetet, kur dhe në ç’formë u shfaqën ata, si dhe debatet që ekzistojnë mbi tipologjinë e tyre. Në të jepen në një rrafsh krahasues perceptimet dhe praktikët e shteteve të Ballkanit ndaj minoriteteve përkatëse. Më pas, trajtohet historia dhe statusi i minoriteteve në Shqipëri, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Autorja jep kornizën e përgjithshme të pushtimit italian në Shqipëri dhe brenda saj vendos minoritetet dhe ndërveprimin e tyre me pushtuesit fashistë dhe shtetet amë, si dhe me forcat politike të interesuara si Balli Kombëtar, Fronti Nacionalçlirimtar në Shqipëri, Fronti Nacionalçlirimtar në Greqi, Jugosllavi etj., nga ku shpaloset dhe roli i vetë minoriteteve në lëvizjen e rezistencës. Burimet dokumentare i lejojnë autores të japë një panoramë interesante mbi veprimtarinë e minoritetit grek. Por bashkëpunimi në Luftën e Dytë Botërore midis forcave progresive të luftës

në Shqipëri dhe në Greqi, nuk mjaftoi që politikanët e pasluftës të linin pas historinë e të mirëkuptoheshin. Në Konferencën e Paqes së Parisit, 1946, Greqia iu kthye sërish “Ligjit të Luftës”, një ligj absurd, i cili vite më pas edhe pse u shpërfill nga diplomacia e të dy vendeve, ai vazhdon të mbijetojë, më së shumti për shkak të pronave të popullsisë çame.

Një hapësirë të konsiderueshme, Dr. Sonila Boçi i lë politikës së shtetit komunist shqiptar për minoritetet gjatë viteve 1945-1950. Autorja shpjegon përqasjet e reja të institucioneve ndërkombëtare ndaj statusit të pakicave. Por ndarja e botës në dy blloqe kundërshtarë, si pasojë e Luftës së Ftohtë, solli mosmarrëveshje midis shteteve edhe për statusin e minoriteteve: doktrina politike e liberalizmit civil u vu përballë doktrinës marksiste të internacionalizmit proletar. Në punim jepen drejtimet kryesore të shtetit shqiptar ndaj minoriteteve në përgjithësi, përfshirja e tyre në projektin për “Bashkim–Vëllazërim”, mësimi i gjuhës kombëtare, zhvillimi i kulturës kombëtare, pjesëmarrja në institucionet politike dhe shoqërore shqiptare etj. Por e gjithë kjo platformë realizohej në kushtet e përcaktimit politik dhe të ndarjes politike që impononte Lufta e Ftohtë. Në një lloj mënyre kjo ka qenë politika *integruese* e shtetit shqiptar për minoritetet brenda bllokut politik ku ai shtet ishte pjesë.

Gjithashtu në punim analizohen në detaje proceset politike, kulturore, arsimore, ekonomike që ndodhnin brenda minoritetit grek, gjë që ka lidhje me ruajtjen dhe zhvillimin e *identitetit* të tij. Nëpërmjet dokumentacionit arkivor, kujtimeve të bashkëkohësve dhe medias së shkruar të kohës, autorja shpjegon në mënyrë bindëse fillimin e vështirë të bashkëjetesës së pakicës greke në Shqipërinë komuniste, por dhe arritjet e kësaj pakice. Tabloja që autorja paraqet me fakte e dokumente bindëse është në kundërshtim me të ashtuquajturin persekutim të minoritetit grek, me të cilin qeveria greke dhe silllogjet greke janë përpjekur të çorientojnë e manipulojnë opinionin zyrtar dhe publik. Nëse në minoritetin grek ka pasur persekutim, ky ka qenë pjesë e persekutimit që i është bërë gjithë popullit shqiptar lidhur me të drejtat e njeriut dhe me të drejta të caktuara politike. Madje mund të thuhet se ndaj minoritetit grek, organet e dhunës në Shqipëri, në shumë raste, kanë qenë më të matura e më të kujdesshme, pasi çdo lëvizje në këtë drejtim ishte në fokus jo vetëm të qeverisë greke por edhe të faktorit ndërkombëtar. Është kjo arsyeja që raporti mes ideologjizimit komunist dhe identitetit të minoriteteve ka në kapitull një trajtim prioritar.

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit kemi jetuar në një kohë tjetër, me mure realë dhe imagjinare që binin çdo ditë në të mirë edhe të bashkëpunimit të studiuesve dhe institucioneve shkencore, me mundësi të mëdha për të shfrytëzuar literaturën relevante dhe arkivat e hapura në çdo anë të globit. Sigurisht këto rrethana kanë qenë një ndihmesë e madhe për autoren në përballimin e “sfidave” që paraqiste monografia e saj e parë. Megjithatë, siç ndodh kur shkruan një libër, vështirësitë qëndrojnë në radhë. Në monografinë e Dr. Sonila

Boçit është e dukshme këmbëngulja e saj në hulumtimin e materialit dokumentar në Arkivin Qendror Shtetëror, në Arkivin e Ministrisë së Jashtme, në Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe në Arkivin e Institutit të Historisë. Ky material është mjaft i copëzuar dhe i shpërndarë në fonde, struktura e dosje të ndryshme, që e bëjnë punën e studiuesit të lodhshme dhe ndonjëherë dhe të mërzitshme. Gjithashtu duhen përmendur vëllimet dokumentare dhe kujtimet e bashkëkohësve, orale apo të shkruara. Ky informacion është trajtuar me korrektesë, pa deformacione subjektive dhe është paraqitur me elegancë, gjë që krijon bindje dhe kënaqësi të lexuesit. Në këtë kontekst, e gjej me vend përdorimin dhe analizën e statistikave për pakicat greke, maqedonase dhe malazeze, ndaj të cilave lexuesi profesional, por edhe publiku i gjerë, është shumë i interesuar.

Për konceptet e kombit, të shtetit, të vetëvendosjes, të pakicave etj., tanimë në botë ka një bibliografi të pasur, të cilën autorja, sidomos në vështrimet juridike e sociologjike e ka shfrytëzuar gjerësisht. Kësisoj, trajtesat teorike mbeten tipari më i dallueshëm jo vetëm i kapitullit të parë, por i gjithë monografisë. Në kolegët e saj kemi ç'të mësojmë nga kjo e veçantë, pasi në punimet tona shkencore aspekti teorik mbetet ende më i neglizhuari dhe më i pa arriri. Dr. Sonila Boçi ka përzgjedhur për analizat e saj literaturë bashkëkohore të shkruar nga autorët më të njohur si Erik Hobsbaum, Will Kymlicka, Hans Kohn, Anthony D. Smith, William James, Jordan Bychkov, John Breuilly, Victor Roudmentof, Vladimir Ortakovski, Nicola Girasoli etj. Ajo na njeh me shkollat, kriteret dhe kategorizimet që ata kanë përdorur, si dhe me rëndësinë që po merr studimi i çështjes së minoriteteve në dhjetëvjeçarët e fundit, si një nga rrugët në kërkim të instrumenteve për të shmangur konfliktet dhe përplasjet brenda një shteti por edhe ndërmjet institucioneve ndërkombëtare. Në punim ndërthuren trajtesa historike me ato teorike dhe kjo e fundit vihet në funksion të subjektit historik. Autorja arrin të bëhet pjesë e debatit për kombin, minoritetet, shtetin, nacionalizmin, memorien kolektive, të drejtën e vetëvendosjes së kombeve, si dhe për një varg dukurish të tjera shoqëruese, siç është dhe gjenerimi i irredentizmit prej vetë minoriteteve apo nga një shtysë e jashtme prej shtetit amë. Duke trajtuar raste analoge në rrethana të ndryshme politike, ekonomike e sociale, autorja arrin në konkluzionin se irredentizmi të minoritetet shfaqet për shkak të rrethanave konkrete të secilit prej tyre dhe duhet studiuar rast pas rasti.

Metodologjia që ndjek autorja në monografinë *Minoritetet kombëtare në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit, 1939-1949*, kalon nga e përgjithshmja tek e veçanta. Të tërheq vëmendjen informacioni dhe analiza bashkëkohore që ajo u bën ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare që kanë pasur lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me çështjen e minoritetit në Shqipëri, si, Konferenca e Paqes në Paris, 1946, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1946, Këshilli i Ministrave të Jashtëm, 1946-1947 etj. Në monografi, studimi i proceseve kombëtare dhe ndërkombëtare dëshmohej si domosdoshmëri për të

studiuar minoritetin nga të gjitha këndvështrimet, si dhe për të përcaktuar faktorët që kanë ndikuar në fatin dhe sjelljen e tij. Një analizë e tillë i ka dhënë frymëmarrje monografisë. Ajo e vendos çdo fenomen në kontekstin historik e gjeopolitik të kohës, gjë që i lejon lexuesit të krijojë një vizion realist për raportet midis ngjarjeve, institucioneve, komuniteteve njerëzore dhe individëve, ku dhe rregullat e lojës së minoriteteve caktohen si një rezultante e përgjithshme forcash e lëvizjesh.

Kultura e përgjithshme ndërdisiplinore, thellësia e mendimit, mendësia bashkëkohore, stili i rrjedhshëm, dëshmojnë për pjekurinë profesionale të studentes së dikurshme të historisë, së cilës unë pas kësaj monografie, plot kënaqësi do t'i uroja:

“Rrugë të mbarë kolegja ime Sonila Boçi!”.

Ana LALAJ

